

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 17.01.2025

Drejtoria e Administratës

Shërbimi për Kuvend dhe Komitete

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës

Prej: Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ali Ismaili



Lënda: Raporti i Punës për punën dhe funksionimin e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës për periudhën janar/dhjetor 2024

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës përmes kësaj informate paraqet punën e vetë për periudhën janar/dhjetor të vitit 2024, e cila është e bazuar në dispozitat dhe detyrimet që dalin për Legjislativin e Komunës, si organi më i lartë i komunës nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjet Sektoriale, Udhëzimet Administrative, Statuti i Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 dhe Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013, për realizimin e punëve dhe detyrat e punës së Legjislativit të Komunës.

Kuvendi i Komunës, mbështetur në kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, ka mbajtur gjithsej njëmbëdhjetë mbledhje të rregullta, dy të jashtëzakonshme dhe një mbledhje solemne. Mbështetur në propozimet e paraqitura për shqyrtim nga Ekzekutivi i Komunës dhe plani i punës së Kuvendit, pas shqyrtimit të propozimeve në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe në fund në Kuvendin e Komunës, është miratuar 'Planin Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës për vitin 2024', 'Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës', 'Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizim e vendeve të Punës në Administratën Komunale', 'Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë' dhe 'Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026', ndërsa në muajin dhjetor në parim për diskutim public është aprovuar 'Projekt-Plani Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027'.

Strukturën e këtij 'Raporti të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024' dhe vendimet e marra nga Kuvendi i Komunës, që do të jenë të përshkruara në listën e vendimeve në formën tabelare, po ashtu për mbledhjet e mbajtura ku përgatitur ekstraktet e procesverbaleve, të cilat janë publikuar në ueb-faqën e komunës pas aprovimit të tyre.

Arsyeja kryesore për kthyerjen në rishqyrtim të disa vendimeve, kryesisht nga MMPHI, MFPT dhe MBPZHR janë synimet dhe programi i Ekzekutivit të Komunës, për zhvillimin ekonomik lokal dhe vendimeve me karakter strategjikë dhe zhvillimor, të cilat kërkohet të vendosen në harmoni me Hartën Zonale të Komunës.

Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, për të gjitha pikat e rendit të ditës që janë shqyrtuar ka pasur debate të hapura dhe përmbajtjesore para marrjes së vendimeve. Vendimet e marra nga Kuvendi i Komunës dhe të konfirmuara nga Ministrinë e linjës janë të publikuara në ueb-faqe. Lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, janë dhënë përgjigje gojore për një pjesë të tyre nga Drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe Nënkryetari i Komunës.

Sfida të Kuvendit mbeten, publikimi i audioincizimeve që duhet të realizohet nga Ekzekutivi i Komunës.

Strukturën e këtij ‘Raporti të punës së Kuvendit të Komunës për periudhën janar/dhjetor 2024’, e paraqesim në formën tabelare për secilin vendim, vendimet e rishqyrtuara dhe aktet e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës.

Pjesë përbërëse e ‘Raportit për punën dhe funksionimin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën janar/dhjetor 2024’, është lista e rregulloreve, planeve, vendimeve, vendimeve të shfuqizuara dhe vendimeve të kthyera në rishqyrtim nga Ministrinë e linjës, të cilat edhe pas rishqyrtimit kanë mbetur në fuqi, meqë nuk janë ndryshuar dhe nuk janë shfuqizuar.

Në muajin prill, me datë 04.04.2024 është lëshuar mbledhja e Kuvendit të Komunës, nga përfaqësuesit e subjektit politikë të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, për arsye të pikës ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, mos dhënies së përgjigjeve nga Ekzekutivi i Komunës, meqë Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ka kaluar në pikën e radhës, po ashtu mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 30.04.2024 është ndërprerë nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, pas pengimit të zhvillimit të saj nga Grupet Parlamentare të Lëvizjes Vetëvendosje 6 anëtarë dhe Partisë Demokratike të Kosovës - 4 anëtarë dhe një anëtar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pas largimit të pikës ‘Pyetje dhe përgjigje parlamentare’, nga rendi i ditës. Kjo mbledhje është vazhduar me datë 13.05.2024, prapë ka mbetur pa kuorum dhe është vazhduar sërish për herën e dytë me datën 16.05.2024. Mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 30.05.2024 është ndërprerë nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në mungesë të kuorumit, pas lëshimit të mbledhjes nga Grupi Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës - 10 anëtarë dhe anëtarë tjerë të Kuvendit të Komunës nga pozita. Kjo mbledhje është vazhduar me datë 18.06.2024.

Përshkrimi i rrjedhës së vendimeve dhe zbatimi i tyre.

Numri i vendimeve të marra për periudhën janar/dhjetor të vitit 2024 në Kuvendin e Komunës është gjithsej 46.

- Numri i vendimeve dhe vendimeve të ndryshuara pas rishqyrtimit dhe në zbatim është 37.
- Numri i vendimeve të rishqyrtuara dhe ndryshuara është 2.
- Numri i vendimeve të shfuqizuara është 1.
- Numri i vendimeve të mbetura në fuqi pas rishqyrtimit është 3.
- Vendimet e mbetura do të rishqyrtohen, në mbledhjen e ardhshme në Kuvendin të Komunës - janar 2025 janë 2.

- Nga muaji dhjetor 2024, një vendime e kemi në procedurë të rishqyrtimit në Ministrinë e linjës.
- Janë miratuar dy rregullore dhe një Statut i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë dhe një plan i veprimit.
- Përveç vendimeve të marra, të radhitura në tabelat e raportit të punës Kuvendi i Komunës ka shqyrtuar edhe:
 - Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023 - prill 2024;
 - Raportin Financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2023 - prill 2024;
 - Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024 - shtator 2024;
 - Raportin Financiar për buxhetin e shpenzuar për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024 - shtator 2024 dhe
 - Raportin e Auditimit të Jashtëm për vitin 2023 - shtator 2024.

Tabela 1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës dhe komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera të Kuvendit për periudhën janar/dhjetor 2024

Emri i Komunës	Mbledhje rregullta	Mbl. Jashtëzakonshme	Mbl. urgjente	Mb. solemne
KUVENDI	11	2		1
K.POL.FINANCA	12			
K.KOMUNITETI	12			
K.AKRS	5			
K.SHMS	0			
K.BMU	0			
K.PUKISHP	0			
K.PNV	0			

Tabela 2 - Planet dhe Rregulloret e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor 2024

1.	Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.	14 07.02.2024	Është e konfirmuar ligjshmëria e planit dhe zbatimi i tij.
2.	Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës.	71 21.05.2024	Është e konfirmuar ligjshmëria e

			Rregullores dhe zbatimi i saj.
3.	Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizim e vendeve të Punës në Administratën Komunale.	144 03.12.2024	Është e konfirmuar ligjshmëria e Rregullores dhe zbatimi i saj.
4.	Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi në Fushë-Kosovë'.	30 07.03.2024	Është e konfirmuar ligjshmëria e Statutit dhe zbatimi i saj.
5.	Plani i Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkolla për vitet 2024-2026.	148 03.12.2024	Është e konfirmuar ligjshmëria e Planit të Veprimit dhe zbatimi i saj.

Tabela 3 - Vendimet e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor 2024

Nr.	Nr. Prot/dt	Emërtimi i vendimit të Kuvendit	Rishqyrtimi i vendimit
1.	14 07.02.2024	Për miratimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
2.	06 07.02.2024	Miratohet Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit ndër-komunal shumë-funksional me Nr. 14-024/01-233042/23, të datës 15.12.2023, e lidhur mes 6 komunave të Republikës së Kosovës si vijon: Kryeqyteti Prishtina, Komuna e Podujevës, Komuna e Lipjanit, Komuna e Fushë-Kosovës, Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
3.	07 07.02.2024	Për aprovimin e Propozimit Nr. 120, të datës 22.01.2024, për lejimin e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej: 266,885.39€ nga buxheti i komunës, programi buxhetor i arsimit me Nr. 92010 prej kategorisë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve apo subvencioneve për pagesën e pagave të mësimdhënësve për vende të lira të punës dhe zëvendësime në vitin shkollorë 2023-2024.	Vendimi është lënë në fuqi, meqë nuk është shfuqizuar në mungesë të votave, nga mos pjesëmarrja në votim e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
4.	08 07.02.2024	Për aprovimin e Propozimit Nr. 752, të datës 16.11.2023, për ndërrimin e destinimit të	Vendimi është lënë në fuqi, meqë nuk është

		përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të evidentuar në ngastrën kadastrale Nr. P-72514027-00166-24, me sipërfaqe S=555m ² , arë e klasës së pestë, në Miradi të Poshtme, në rrugën 'Miradi', sipas certifikatës së pronës me Nr. 14-942-22699 për palën Gëzim Bullatovci. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore bëhet për ndërtimin e objektit individual-shtëpi banimi.	shfuqizuar në mungesë të votave, nga mos pjesëmarrja në votim e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
5.	11 07.02.2024	Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.5, të vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, duke e larguar e z. Durim Hajra nga përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa prej shtatë anëtarëve dhe për caktimin e z. Vlonjat Hasani në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Politikë dhe Financa.	Vendimi për ndërrimin e anëtarëve është i zbatueshëm pas verifikimit të tij sipas afatit ligjor.
6.	13 07.02.2024	Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3, të vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, duke e larguar z. Shpend Bardiqi nga përbërja e Komitetit për Komunitete prej nëntë anëtarëve dhe për caktimin e znj. Doruntina Jashari në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Komunitete.	Vendimi për ndërrimin e anëtarëve është i zbatueshëm pas verifikimit të tij sipas afatit ligjor.
7.	11 07.02.2024	Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 51, të datës 07.03.2022 për themelimin e Komitetit për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport, për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, duke e larguar z. Vlonjat Hasani nga përbërja e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport prej pesë anëtarëve dhe caktimin e z. Durim Hajra në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.	Vendimi për ndërrimin e anëtarëve është i zbatueshëm pas verifikimit të tij sipas afatit ligjor.
8.	12 07.02.2024	Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 52, të datës	Vendimi për ndërrimin e anëtarëve është i

		07.03.2022, për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, duke e larguar znj. Doruntina Jashari nga përbërja e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale prej pesë anëtarëve dhe caktimin e z.Habib Mekolli në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.	zbatueshëm pas verifikimit të tij sipas afatit ligjor.
9.	13 07.02.2024	Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3, të vendimit Nr. 94, të datës 31.03.2022 për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban, Infrastrukturë dhe Shërbime Publike, për ndërrimin e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje, duke e larguar z. Habib Mekolli nga përbërja e Komitetit për Planifikim Urban, Infrastrukturë dhe Shërbime Publike prej pesë anëtarëve dhe caktimin e z. Shpend Bardiqi në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Planifikim Urban, Infrastrukturë dhe Shërbime Publike.	Vendimi për ndërrimin e anëtarëve është i zbatueshëm pas verifikimit të tij sipas afatit ligjor.
10.	27 04.02.2024	Për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2023 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 389,203.44€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike buxhetore: paga e shtesa, subvencione e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet buxhetore të programeve, nënprogrameve dhe projekteve.	Vendim është kthyer në rishqyrtim dhe është ndryshuar, me vendimin Nr. 40, të datës 11.04.2024.
11.	31 07.02.2024	Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2023, në vitin fiskal 2024 transfer dhe rialokime në shumë të përgjithshme prej 6,318,133.88€, sipas propozimit dhe përshkrimit në dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 394, të datës 13.02.2024, me ndryshimet e propozuara në Kuvendin e Komunës për 'Dixhitalizimin e Sallës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës', të prezantuara në formën tabelare prej dy faqeve - pjesë e këtij vendimi.	Vendim është kthyer në rishqyrtim dhe është ndryshuar, me vendimin Nr. 45, të datës 11.04.2024.

12.	29 07.03.2024	Për aprovimin e Propozimit Nr. 420, të datës 20.02.2024, për vazhdimin e lirimit të bizneseve nga pagesa e taksës komunale për vitet 2023, 2024 dhe 2025, për të gjitha subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit. Lirimi i subjekteve afariste nga taksa komunale e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike nga viti 2017-2022, me vendimet e Kuvendit të Komunës dhe vazhdimin e lirimit për periudhën e ardhshme të evidentuar në pikën një të vendimit, synon ruajtjen e vendeve të punës dhe rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik lokal nga Sektori privat në fushën e veprimtarive të tregtisë, shërbimeve, ndërtimtarisë, prodhimit, akomodimit dhe mikro - bizneseve, ku përfitues tani janë gjithsej 2750 biznese, të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.	Vendimi është i zbatueshëm, pas plotësimit të afateve ligjore për zbatimin e vendimit.
13.	28 07.03.2023	Për rishqyrtimin e Kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 0-36/1, të datës 13.02.2024, lidhur me ligjshmërinë e Rregullores për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës Nr. 228, të datës 29.12.2023, me aprovimin e kërkesës për ndryshim-plotësimin dhe harmonizim e kësaj rregullore me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023, për Administratë të Hapur në Komuna.	Sqarim: Rregullorja për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës Nr. 228, të datës 29.12.2023, është e shfuqizuar dhe duhet të përgatitet Rregullorja e re konform dispozitave ligjore të Udhëzimit Nr. 04/2023 Administrativ për Komuna të Hapura.
14.	30 07.03.2024	Për aprovimin në parim të 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë' dhe procedimin e tij për diskutim publik.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij,
15.	40 11.04.2024	Për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 27, të datës 04.03.2024 për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2023 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 389,203.44€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike	Vendimi është kthyer në rishqyrtim dhe është ndryshuar, pas ndryshimit është i zbatueshëm.

		buxhetore: paga e shitesa, subvencione e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet buxhetore të programeve, nënprogrameve dhe projekteve.	
16.	45 11.04.2024	Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022 dhe 2023, për shpenzim në vitin fiskal 2024 transfer dhe rialokime në shumë të përgjithshme prej 5,928,930.44€, sipas propozimit dhe përshkrimit të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 423, të datës 25.03.2024 me ndryshime, për kategoritë ekonomike të shpenzimeve.	Vendimi është kthyer në rishqyrtim dhe është ndryshuar, pas ndryshimit është i zbatueshëm.
17.	44 11.04.2024	Për lejimin e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve për bujqësi në shumë prej: 120,000.00€, nga të hyrat vetanake për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2024.	Vendimi është i zbatueshëm, pas plotësimit të afateve ligjore për zbatimin e vendimit.
18.	43 11.04.2024	Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Selman Riza', në Komunën e Fushë-Kosovës.	Vendimi është i zbatueshëm, pas plotësimit të afateve ligjore për zbatimin e vendimit.
19.	41 11.04.2024	Për shfuqizimin e aprovimit në parim të vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023 të 'Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.	Është shfuqizuar vendimit Nr. 31, të datës 06.02.2023, për aprovimin në parim të të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, për arsye të ndryshimit të tarifave për mbeturina.
20.	42 11.04.2024	Për aprovimin në parim të 'Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës' dhe procedimin e saj për diskutim publik.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
21.	71 21.04.2024	Për miratimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Vendimi është i zbatueshëm, pas plotësimit të afateve

			ligjore për zbatimin e vendimit.
22.	73 21.05.2024	Për Miratimin e 'Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
23.	75 21.05.2024	Për ndryshimin e paragrafit 1 të vendimit Nr. 171, të datës 05.07.2022, nën paragrafit 1.1, për ndërrimin e anëtarit të deritashëm z. Laureat Gojnovci, me anëtarin e ri z. Jahush Krasniqi dhe caktimin e tij, si anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve, në kuadër të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', që operon dhe ushtron veprimtarinë e saj në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Vendimi për ndërrimin e anëtarëve është i zbatueshëm pas verifikimit të tij sipas afatit ligjor.
24.	76 21.05.2024	Për caktimin e lokacionit për fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e shkollës së futbollit në fshatin Sllatinë e Vogël të Komunës së Fushë-Kosovës.	Vendimi është i zbatueshëm, pas plotësimit të afateve ligjore për zbatimin e vendimit.
25.	88 25.06.2024	Për zgjedhjen e anëtarëve të pesë Komisioneve për rekrutimin e Drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Fushë-Kosovës.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
26.	91 27.06.2024	Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2025 - 2027, në Komunën e Fushë-Kosovës, me kufijtë e caktuar buxhetor.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
27.	102 02.08.2024	Për aprovimin në parim të Projekt-Dokumenti për vlerësimin e rrezeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Sqarim: Duke u mbështetur në udhëzimet e dhëna nga Agjensia për Menaxhimin e Emërgjencave për të gjitha Komunitetet e Kosovës, ky 'Projekt-Dokument' për vlerësimin e rrezeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', duhet të përgatitet me përmbajtje dhe standarde unike në nivel vendi.


28.	103 02.08.2024	Për financimin e shujtave ditore për nëpunësit e Shërbimit Civil të Administratës të Komunës së Fushë-Kosovës.	Vendimi është i zbatueshëm, pas plotësimit të afateve ligjore për zbatimin e vendimit.
29.	104 02.08.2024	Për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 31.12.2021.	Sqarim: Vendimi është kthyer në rishqyrtim për arsye të ndryshimit të strukturës së barazisë gjinore në përbërjen e Komitetit për Komunitete dhe ndryshuar me vendimin me Nr. 123 të datës 03.10.2024.
30.	118 27.09.2024	Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025.	Vendimi është i zbatueshëm.
31.	117 27.09.2024	Për lejimin e vizitës zyrtare në Këshillin Bashkiak të Bashkisë së Tiranës Republikën e Shqipërisë.	Vendimi është i zbatueshëm.
32.	122 03.10.2024	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratës Komunale.	Vendimi është i zbatueshëm.
33.	121 03.10.2024	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026.	Vendimi është i zbatueshëm.
34.	123 03.10.2024	Për rishqyrtimin e vendimit Nr. 104, të datës 02.08.2024 dhe bën ndryshim - plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 29.12.2021 me zëvendësimin e dy anëtarëve të Komitetit për Komunitete.	Vendimi për ndërrimin e anëtarëve është i zbatueshëm pas verifikimit të tij sipas afatit ligjor.
35.	120 03.10.2024	Për aprovimin e Propozimit Nr. 1047, të datës 02.09.2024 për shpalljen me interes Publik dhe fillimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e objektit të Xhamisë në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë.	Vendimi është kthyer në rishqyrtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe është ndryshuar nga Kuvendi i Komunës me 146, të datës 03.12.2024.

36.	123 23.10.2024	Për aprovimin e Propozimit Nr. 1291, të datës 09.10.2024 për bartjen dhe transferimin e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e rezervës në kategorinë ekonomike të projekteve kapitale për vitin 2024.	Vendimi i marrë nuk është zbatuar dhe transferimin e këtyre mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e rezervës në kategorinë ekonomike të projekteve kapitale për vitin 2024, duhet ta ndryshohet me bartjen e buxhetit të pashpenzuar në vitin 2024.
37.	144 03.12.2024	Për miratimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.	Vendimi është i zbatueshëm, pas plotësimit të afateve ligjore për zbatimin e vendimit.
38.	147 03.12.2024	Për miratimin e Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026.	Vendimi është i zbatueshëm, pas plotësimit të afateve ligjore për zbatimin e vendimit.
39.	143 03.12.2024	Për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 93, të datës 31.03.2022 për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Vendimi është i zbatueshëm.
40.	137 26.11.2024	Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.	Sqarim: Vendimet për Grupe Punues dhe Komisione të punës nuk shqyrtohen, ato mund të zbatohen pas aprovimit të tyre.
41.	139 03.12.2024	Për aprovimin e Propozimit Nr. 1447, të datës 15.11.2024, për shfrytëzimin e mjeteve financiare të mësimi joformal.	Sqarim: Vendimi Nr. 139, i datës 03.12.2024, është kthyer në rishqyrtim me datën 06.01.2025 dhe është në rishqyrtim në mbledhjen e muajit janar 2025.
42.	142 03.12.2024	Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Sportistëve të vitit 2024.	Vendimi është i zbatueshëm.
43.	141 03.12.2024	Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Krijuesit të vitit 2024.	Vendimi është i zbatueshëm.

44.	140 03.12.2024	Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorëve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' dhe Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' - Aneksi I në Komunën e Fushë-Kosovës.	Vendimi është i zbatueshëm.
45.	146 03.12.2024	Për aprovimin e Propozimit Nr. 2096, të datës 15.11.2024 për ndryshim-plotësimin vendimit Nr. 120, të datës 03.10.2024, sipas shkresës zyrtare 020-619/2, të datës 21.10.2024 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.	Ky vendim ka mbetur që të rishqyrtohet sërish në mbledhjen e radhës - janar 2025.
46.	164 30.12.2024	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit-Komunal për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2025-2027.	Është në procedurën e shqyrtimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.
	Përshkrimi i rrjedhës së vendimeve dhe zbatimi i tyre.	Numri i vendimeve të marra gjithsej në Kuvendin e Komunës është 46.	Numri i vendimeve në zbatim dhe vendimeve të ndryshuara pas rishqyrtimit dhe në zbatim është 37. Numri i vendimeve të rishqyrtuara dhe të mbetura në fuqi, pas rishqyrtimit në Kuvendin e Komunës dhe që janë në zbatim është 2 - vendimi Nr. 40 dhe vendimi Nr. 45. Numri i vendimeve të shfuqizuara është 1 - vendimi Nr. 41. Numri i vendimeve të ndryshuara dhe të kthyera në rishqyrtim pas ndryshimit të tij është 1 - vendimi me Nr. 146, në rishqyrtim - janar 2025. Është marrë edhe një vendim që kërkon hartimin e ri të

			<p>Rregullores për Transparencë sipas UA për Komuna të hapura Nr. 04/2023.</p> <p>Është në zbatim vendimi për përbërjen e Komitetit për Komunitete i rishqyrtuar në Kuvendin e Komunës për plotësimin e kriterit gjinor - vendimi Nr. 123 E kemi edhe vendimin për mjetet financiare të kategorisë ekonomike të rezervës të bartura në projekte kapitale - tetor 2024, i cili nuk është zbatuar.</p> <p>Nga muaji dhjetor 2024, i kemi edhe dy 2 vendime të bartura në procedurë të rishqyrtimit në muajin janar 2025, ku njëri prej tyre është kthyer me datën 06.01.2025 - vendimi me Nr. 139 dhe vendimi tjetër Nr. 146 - janë në rishqyrtim - janar 2025.</p>
--	--	--	---

Shtojcë e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024, është edhe ‘Raporti i Punës së Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport për vitin 2024’, i përgatitur nga Kryesuesja e Komitetit dhe anëtarët e Komitetit.



Shemsije Fetahu¹, Durim Hajra², Migjen Kolshi² dhe Jahush Krasniqi²
¹kryetare dhe ²anëtar

**RAPORTI VJETOR I PUNËS DHE AKTIVITETEVE TË
KOMITETIT (AKRS) F. KOSOVË**

**Monitorimi i fushave të arsimit, kulturës, rinisë dhe sportit, për
vitin 2024**

Fushë Kosovë, Janar 2025

*Raporti vjetor i punës dhe aktiviteteve të komitetit (AKRS) Fushë Kosovë
për vitin, 2024*

Përmbajtje:

I. PLANI, PROGRAMI I PUNËS DHE AKTIVITETET E KOMITETIT TË AKRS.....	3
1.1 Plani i punës dhe rishikimi i aktiviteteve të AKRS.....	3
1.2 Aprovimi i programit të punës dhe aktiviteteve për vitin 2024.....	3
1.3 Takime e Komitetit të AKRS gjatë viti 2024.....	4
II. MONITORIMI NË SHFMU “M. GRAMENO” F. KOSOVË & “ZEJNEL SALIHU” BARDH I MADH	5
2.1 Dinamika e monitorimit të institucioneve shkollore.....	5
2.2 ShFMU “Mihajl Grameno” F. Kosovë me anekset	5
2.3 ShFMU “Zejnel Salihu “ Bardh i Madh	7
III. BARRIERAT E PUNËS TË AKRS PËR VITIN, 2024.....	9
3.1 Komiteti i AKRS dhe barrierat ligjore	9
3.2 Vështirësitë në zgjedhjen e nënkryetarit të komitetit të AKRS –së.....	9
3.3 Anëtarëve të AKRS dhe zëvendësimet.....	9
3.4 Barrierat financiare	9
IV. KËRKESË DREJTUAR ORGANEVE VENDIMMARRËSVE NË F. KOSOVË.....	10

*Raporti vjetor i punës dhe aktiviteteve të komitetit (AKRS) Fushë Kosovë
për vitin, 2024*

I. PLANI, PROGRAMI I PUNËS DHE AKTIVITETET E KOMITETIT TË AKRS

1.1 Plani i punës dhe rishikimi i aktiviteteve të AKRS

Qëllimi: Plani i punës dhe aktiviteteve për vitin 2024, është dokumenti kryesor i funksionimit normal të Komitetit, konform fushave që mbulon AKRS.

Objektivat: Rishikimi i aktiviteteve dhe rezultateve nga viti 2023, por edhe planifikimi i punës dhe aktivitetet për vitin 2024, të dizajnuara në tre dimensione:

- a. *Planifikimi kohor i aktiviteteve;*
- b. *Bashkëveprimi: aktivitet – veprim;*
- c. *Rezultatet e pritura dhe të realizuara.*

Tabela 1.2 Plani, programi i punës dhe aktiviteteve për vitin 2024

Muajt	Aktiviteti- Veprimi	Rezultati
I-II	Konsultë për vazhdimin e punës dhe aktivitetet e AKRS. Plani vjetor i punës dhe statusi i AKRS.	Koncept dokumenti i punës dhe aktiviteteve i shqyrtuar. Njoftim për takimet e AKRS. Propozim për shqyrtimin e Statusit të AKRS (vullnetar ose me buxhet)!
III	Shqyrtimi i planit dhe aktiviteteve të AKRS për vitin 2024. Shqyrtim i propozimit drejtuar organeve vendim marrëse.	Plani i punës dhe aktiviteteve për vitin 2024 (i aprovuar). Propozimi i adresuar organeve vendimmarrëse.
IV	Përcaktimi i prioriteteve për fushat e AKRS. Përgatitja e pyetësorit dhe agjenda e vizitave. Organizimi i vizitave sipas prioriteteve.	Prioritete të caktuara sipas fushave Pyetësor të hartuar Agjendë e caktuar dhe vizitat e realizuara
V	Rishikimi i dinamikës së vizitave dhe gjetjeve sipas fushave të AKRS.	Vlerësimi i planit të punës dhe aktiviteteve të realizuara të AKRS.
VI	Rishikimi i planit të punës për aktivitete 6- mujore të vitit 2024.	Plani rishikuar
VII	Shqyrtim i mundësisë për vizitë - në regjion.	Vizitë e realizuar dhe përvoja të këmbëra
VIII	Vazhdim të vizitave sipas fushave të AKRS-së.	Vizita të realizuara në institucione.
IX	Diskutimi i rezultateve nga vizitat në terren.	Puna e grupeve në terren

*Raporti vjetor i punës dhe aktiviteteve të komitetit (AKRS) Fushë Kosovë
për vitin, 2024*

X	Takimi i komitetit të AKRS Analiza e raporteve nga terreni.	Diskutime për përmirësimin e metodologjisë së hulumtuese dhe shtjellimi i rezultateve.
XI	Hartimi i raportit vjetor për punën dhe aktivitete gjatë vitit 2024.	Raport i hartuar për vitin 2024
XII	Shqyrtim dhe aprovim të raportit final për rezultatet e arritura gjatë vitit 2024.	Prezantim i raportit final, në Asambleenë Komunale, për vitin 2024.

Kryetarja e AKRS, bashkë me anëtarët e komitetit, gjatë janarit zhvilluan konsulta kolegjiale lidhur me rishikimin e planit të punës dhe aktiviteteve për vitin 2024, në raport me kapacitet ekzistuese të komitetit. Metoda e tillë e punës, anëtarëve i mundësoi koordinimin e aktiviteteve të AKRS, në përputhje me angazhimet e tyre politike, por edhe obligimet profesionale. Pas analizës të projekt dokumentit, anëtarët reflektuan me propozime për planin e punës. Puna dhe aktiviteti u fokusua në monitorin e institucioneve të fushave që mbulon AKRS, me qëllim të konstatimit gjendjes reale (Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport). Me plan u përcaktuan aktivitetet në përputhje me misionin e AKRS, qasja e tillë ishte kontribut për vendimmarrje unanime.

1.2 Aprovimi i programit të punës dhe aktiviteteve për vitin 2024.

Aprovimi i planit të punës dhe aktiviteteve, nga fillimi e deri në fund të vitit (2024) ishte dokumenti kryesor, që përcaktoi objektivat e planifikuara. Përgatitjet dhe diskutimet paraprake kontribuan, që seancat AKRS, të jenë racionale dhe plani i punës të aprovohet me konsensus kolegjial, i prezantuar në (Tabela 1. 2).

1.3 Takime e Komitetit të AKRS gjatë viti 2024

AKRS, organizoi dhe realizoi takimet e veta sipas planifikimit kalendarik. Në takimet e saja rregullisht ishin prezent: Z. Hajrullah Gerguri, në disa takime edhe Z. Hasan Gjyrevci. Në takimet e tilla pjesëmarrës ishte kryesuesi i kuvendit, drejtorë dhe zyrtarë të arsimit dhe kulturës. Në takime u diskutuan puna dhe aktivitetet e planifikuara, por edhe u adresuan kërkesa për vendimmarrësit e Komunës. Çështjet e diskutuara janë aprovuar, ndërsa temat dhe rezultatet janë evidentuar në procesverbale dhe ekstrakte të cilët janë në arkiv të Komunës.

Tabela 1.3 Takimet e Komitetit të AKRS gjatë viti 2024	
Data	Pjesëmarrës
4. 03. 2024	Anëtarët e AKRS Z. Hajrulla Gerguri; Z. Hasan Gjyrevci Zyrtarete :
27. 05. 2024	Anëtarët e AKRS dhe Z. Hajrulla Gerguri Z.Hasan Gjyrevci
20 .09. 2024	Anëtarët e AKRS dhe Z. Hajrulla Gerguri Z.Hasan Gjyrevci
25.10. 2024.	Anëtarët e AKRS dhe Z. Hajrulla Gerguri Z.Hasan Gjyrevci
19. 12. 2024	Anëtarët e AKRS dhe Z. Hajrulla Gerguri Z.Hasan Gjyrevci

*Raporti vjetor i punës dhe aktiviteteve të komitetit (AKRS) Fushë Kosovë
për vitin, 2024*



II. MONITORIMI NË SHFMU “MIHAJL GRAMENO” F. KOSOVË & “ZEJNEL SALIHU” BARDH I MADH

2.1 Dinamika e monitorimit të institucioneve shkollore

Qëllimi i vizitës: Monitorim i gjendjes ekzistuese në shkolla dhe funksionimi i tyre (mundësit, përparësitë, vështirësitë dhe kërkesat), në realizimin e misionit të tyre.

Objektivat: Identifikimi i indikatorëve të përgjithshme dhe specifike të punës në shkolla.


Metodat e punës: Bashkëbisedim me drejtor apo përgjegjës të shkollave (KDSH, KP, KN), psikolog, pedagog etj. Identifikim të indikatorëve përmes pyetësorit, lidhur me funksionim e punës edukative arsimore në shkollë. Analiza e të dhënave për indikatorët e monitoruar, përmes gjetjeve, rekomandimeve me arsyetim për secilën shkollë.

2.1 Monitorimi i Institucioneve shkollore		
Shkollat- Komuna -Fushë Kosovë	Data- vizitës	Qëllimi
ShFMU “Mihajl Grameno ” amë, Fushë Kosovë	20. 06. 2024	Monitorim & Bashkëbisedim
ShFMU “Mihajl Grameno ” Aneksi 1, F. Kosovë	6. 12. 2024	Monitorim & Bashkëbisedim
ShFMU “Mihajl Grameno ” Aneksi 3, F. Kosovë	6. 12. 2024	Monitorim & Bashkëbisedim
ShFMU “Zejnel Salihu ” Bardh i Madh	08. 10. 2024	Monitorim & Bashkëbisedim

Vizitë në shkollat e F. Kosovës (anëtarët e komitetit)



Vizitë në SHFMU : "M. Grameno" – amë



Vizitë në SHFMU "M. Grameno" aneksi 1



Vizitë në SHFMU : "M. Grameno" – amë



Vizitë në SHFMU : "M. Grameno" – aneksi 3

2.2 ShFMU "Mihajl Grameno" F. Kosovë me anekset

Në ShFMU "Mihajl Grameno", bashkëbisedues të AKRS" ishin: Zv . Drejtori, Pedagogu dhe sekretari i shkollës, përfaqësuesit e (KDSH dhe KA). Anëtarët e komitetit, identifikuan tregues të natyrave të ndryshme. Gjetjet për shkollën "M. Grameno " amë me dy anekset 1 & 3, janë analizuar dhe ato janë shndërruar në rekomandime me arsyetime në vijim:

Gjetja 1.	Klasa të mbingarkuara, numër i madh i nxënësve në klasa, pasojë e mungesës së hapësirës shkollore (shkollën amë dhe dy anekset).
Rekomandim	Shqyrtim i mundësisë për zgjerim të hapësirave shkollore.
Arsyetimi	Respektim të standardit për numrin optimale të nxënësve për klasë.
Gjetja 2.	Mungesë e asistentëve, për punë me nxënës me nevoja të veçanta (shkollën amë dhe dy anekset).
Rekomandim	Punësim të asistentëve për punë me kategorinë e tillë të nxënësve
Arsyetimi	Respektim të standardeve të arsimit dhe cilësisë së punës me nxënësit e tillë
Gjetja 3	Klasa të pa ngjyrosura (shkollën amë)
Rekomandim	Ngjyrosje e klasave
Arsyetim	Kontribut për higjienë në shkollë dhe kushte më cilësore
Gjetja 4	Mungesë mjeteve didaktike, Llapotop, rrjet i dobët i internetit (ame)
Rekomandim	Investime në pajisje didaktike dhe fuqizimi të rrjetit të internetit
Arsyetim:	Kontribut për zbatim të kurikulës dhe avancim të cilësisë së mësimdhënies.

*Raporti vjetor i punës dhe aktiviteteve të komitetit (AKRS) Fushë Kosovë
për vitin, 2024*

<i>Gjetja 5.</i>	Numër i pamjaftueshëm i punëtorëve teknik (shkollën amë dhe dy anekset).
<i>Rekomandim</i>	Shtim të personelit teknik për mirëmbajtje të higjienës në shkollë
<i>Arsyetim:</i>	Ngritje të cilësisë së pastërtisë ose investime në modernizim të pajise higjienike.
<i>Gjetja 6.</i>	Rreziku me lojën “tik- tok”, nxënës të lënduar.
<i>Rekomandim</i>	Zbatim të rregulloreve shkollore (ndalim të telefonave brenda shkollës)
<i>Arsyetim</i>	Respektim i normës ligjore dhe mbrojtje të shëndet të nxënësve
<i>Gjetja 7.</i>	Vend vakant i Zv. drejtorit, (i pa zgjedhur - shkollën amë)
<i>Rekomandim</i>	Emërim-zgjedhje të Zv. Zëvendës drejtorit,
<i>Arsyetim</i>	Kontribut në menaxhim të shkollës, e cila punon me tre ndërrime.
<i>Gjetja 8.</i>	Gjenerator jo funksionar (aneksi 1)
<i>Rekomandim</i>	Te riparohet gjeneratori
<i>Arsyetim</i>	Mungesa e tyre ndikon në ndërprerjen e mësimit për shkak të sezonit të dimrit dhe mungesës së ndriçimit.
<i>Gjetja 9.</i>	Mungesa e sallës sportive aneksi 1 & 3
<i>Rekomandim</i>	Rregullim të sallave dhe terreneve sportive
<i>Arsyetim</i>	Sallat, terrenet sportive, ndihmojnë në fazat e rritjes dhe zhvillimit të nxënësve, realizimin e programit edukativ arsimor. Qendrat e tilla, iu shërbejnë rinisë për aktivitete jashtë shkollore për zhvillim të shkathëtisë sportive, plotësim i kohës së lirë dhe evitim i sjelljeve devijante.
<i>Gjetja 10</i>	Objekti i shkollës “Mihajl Grameno” Aneksi 1 “, ka çati të dëmtuar
<i>Rekomandim</i>	Rregullim të çatisë të objektit të shkollë
<i>Arsyetim</i>	DKA të emëroj një komision profesional për hartimin e projektit për meremetim dhe riparim të çatisë . Realizimi i këtij projekti është në funksion të krijimit të kushteve më të mira punës, ruajtjes së shëndetit të nxënësve dhe kursim të energjisë dhe buxhetit .
<i>Gjetja 11.</i>	Mungesa e Bibliotekës-Aneksi 3- F. Kosovë
<i>Rekomandim</i>	Të furnizohen shkollat me literaturë adekuate e cila është në harmoni me kurikulën, por edhe me bibliotekë elektronike.
<i>Arsyetim:</i>	Paraprakisht, Drejtoria komunale të emëroj një komision profesional për të hartuar listën e literaturës adekuate që i përgjigjet kurrikulës mësimore. Plotësimi i këtij indikator, ndikon në avancim e mësimdhënies dhe mësim-nxënies dhe sigurohet cilësia e mësimit teorik dhe praktikë.
<i>Gjetja 12</i>	Ndriçimi publik (aneksi 1)
<i>Rekomandim</i>	Të riparohet dhe rregullohet ndriçimi i publik në shkolla.
<i>Arsyetim:</i>	Ndriçimi publik, krijon siguri për nxënësit gjatë ndërrimit të dytë dhe të tretë .

Për shkollën amë dhe dy anekset 1 & 3 “M. Grameno”, fillimisht janë identifikuar 12 indikator, ndërsa të tjerët do të analizohen nga pyetësi, të cilat do të përpunohen në vazhdim.

*Raporti vjetor i punës dhe aktiviteteve të komitetit (AKRS) Fushë Kosovë
për vitin, 2024*

2.3 ShFMU “Zejnel Salihu “ Bardh i Madh

Në ShFMU “Zejnel Salihu”, bashkëbisedues të “AKRS” ishin Z. Salih Jashanica -drejtor; Z. Driton Hasolli -sekretar dhe Erona Mjekiqi-psikologe. Gjetjet për shkollën “Zejnel Salihu” pas analizës u shndërruan në rekomandime me arsyetime sikur në vijim:

<i>Gjetja 1</i>	Mësimi zhvillohet me një ndërrim, hapësira shkollore e mjaftueshme Stafi arsimor i kompletuar; Kushtet e punës të përmirësuara.
<i>Rekomandim</i>	DKA, të vazhdojë me trendin e investimeve edhe në shkollat tjera.
<i>Arsyetim:</i>	Investimet e DKA, në infrastrukturë shkollore, janë të dukshme dhe pozitive; Plotësimi i kushteve të punës, parakusht për avancim të cilësisë së mësimin të, por edhe mërqinje të nxënësve dhe stafit të shkollës. <i>Komunën dhe DKA-në e përgëzojmë për investimet e tilla!</i>
<i>Gjetja 2.</i>	Një nxënës me iniciale A. Q, ka sjellje që nuk përputhen me kodin etik dhe rendin shtëpiak të shkollës ! Për këtë rast, DKA- ka angazhuar një psikologe për ta ndihmuar nxënësin në korrigjimin sjelljeve në shkollë. Psikologu, vlerëson se: nxënësi në shkollë ka sjellje që bien ndesh me rendin shtëpiak të shkollës në raport me shokë dhe stafin e shkollës. Psikologu karakterin e tij konsideron si hiperaktive, si pasojë e problemeve familjare (prindërit e divorcuar). <i>AKRS- Kishte dy pyetje për psikologun lidhur për rastin e tillë:</i> 1. A ka përmirësim të sjelljes së nxënësit, nga fillimi i punës suaj ? Ajo deklaroi se është kohë e shkurtër (2 javë), për të vërejtur efektet pozitive të nxënësit! 2. A ju nevojitet më shumë kohë për të vërejtur rezultatet e përmirësimit? Po patjetër, nevojitet punë sistematike për një afatë më të gjatë kohor.
<i>Rekomandim:</i>	Vazhdim të punës së psikologes, në mënyrë që nxënësi të përmirësoj sjelljet e tij, jo vetëm në shkollë por edhe në mjediset tjera.
<i>Arsyetim:</i>	Koha e shkurtër e punës së psikologes, nuk mund të jep rezultate të shpejta, dhe kërkohet më shumë kohë dhe punë sistematike me nxënësin.
<i>Gjetja 3.</i>	Puna e psikologes është obligative jo vetëm në këtë rast !
<i>Rekomandim:</i>	DKA, të kërkojë raport javor, lidhur me sjelljen e nxënësit
<i>Arsyetim:</i>	Monitorimi i sjelljes së nxënësit, është e domosdoshmëri nga aspekti edukativ, arsimor, ligjor dhe shoqëror. Varësisht nga suksesi i psikologes, më pas të kërkohen opsione tjera.
<i>Gjetja 4.</i>	Përgjegjësitë e shkollave të monitoruara, Komitetin e AKRS e përgëzojnë për monitorim të kushteve në shkolla.
<i>Rekomandim:</i>	Përgjegjësit e shkollave, aktivitetet e AKRS, i konsiderojnë si ndihmë konkrete në identifikimin e indikatorëve të punës në shkolla, por edhe kontribut për ngritja të cilësisë në arsim.
<i>Arsyetim:</i>	Përgjegjësit e shkollave, punën e AKRS, me respekt e mirëpresin dhe e vlerësojnë të madh punën e tyre, për dy arsye:

Raporti vjetor i punës dhe aktiviteteve të komitetit (AKRS) Fushë Kosovë
për vitin, 2024

<p><i>Puna e AKRS, ekskluzivisht është profesionale, ndihmë konkrete në identifikim të indikatorëve të përgjithshëm dhe specifikë në proceset edukative arsimore.</i></p> <p><i>Puna dhe kontributi i AKRS, vlerësohet me kolegjalitet, kontribut vullnetar dhe këshillëdhënëse.</i></p>
--

Për shkollën “Zejnel Salihu”, fillimisht janë identifikuar 4 indikator, ndërsa të tjerët do të analizohen nga pyetësi, të cilat do të përpunohen në vazhdim.

III. BARRIERAT E PUNËS TË AKRS PËR VITIN, 2024

3.1 Komiteti i AKRS dhe barrierat ligjore

Puna dhe aktivitetet Komitetit të AKRS u ballafaqua me barrierat të cilat u reflektohen në realizimin e objektivave të planifikuara, të cilat mund të vlerësohen si:

- a. Pengesa administrative dhe ligjore,
- b. Mungesë e vullnetit për financim të punës dhe aktiviteteve

3.2 Vështirësitë në zgjedhjen e nënkryetarit e komiteti të AKRS –së

Nënkryetarja e AKRS, Znj. Fitore Simnica, kaloi në pozitë tjetër, për pasojë pozita e nënkryetarit është vakantë.

AKRS, kërkoi nga asambleja komunale të emëroj një anëtar nga radhët e veta, për të plotësuar boshllëkun ekzistues !

3.3 Anëtarëve të AKRS dhe zëvendësimet

AKRS, përbehet nga anëtarët e partive politike të asamblesë komunale, zëvendësi i anëtarëve ndikon në rezultat të punës dhe aktiviteteve. **Z. Vlonjat Hasani**, është zëvendësuar nga **Z. Durim Hajra**, veprimi i tillë kërkon zhvillim të procedurave përkatëse. Kryetarja e Komitetit, në emër të saj dhe të anëtarëve falënderoi **Z. Vlonjat Hasani**, për kontributin e dhënë nga themelimi e deri në momentin e zëvendësimit të tij. Kryetarja dhe anëtarët e komiteti **Z. Durim Hajra** i dëshiruan mirëseardhje i ofruan informata lidhur me rolin, misionin, vizionin, kompetencat, funksionin, detyrat dhe përgjegjësit të komitetit të AKRS.

3.4 Barrierat financiare

Masat ekzistuese administrative janë pengës e bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar. Me udhëzim për Qeverisje lokale, mundësohet organizimin e vizitave me karakter bashkëpunimi dhe informimi brenda dhe jashtë territorit të Kosovë.

Qëllimi i bashkëpunimit është me interes:

- a. Prezantim i arritjeve dhe rezultateve në nivel vendor dhe ndërkombëtarë
- b. Këmbim të përvojave në mes dy shteteve tona dhe atyre të bashkësisë evropiane.

IV KËRKESË DREJTUAR ORGANEVE VENDIMARRËSVE NË F. KOSOVË

Për: Z. Burim Berisha - Komunës së F. Kosovës - Kryetar

Në dijeni: Z. Besnik Osmani- nënkryetar; Ali Ismajli – kryesues i kuvendit komunal

Nga: Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (AKRS) F. Kosovë

Përmbajtja: Shqyrtim të statusit financiar për zhvillimin e punës dhe aktivitete të AKRS
F. Kosovë, 28. 02. 2024

I nderuar,

Disa karakteristika të AKRS, nga themelimi e deri sot, fillimisht, nuk gjeti asnjë model apo gjurmë të punës për misionin, vizionin dhe objektivat e AKRS, të gjitha këto me shumë mund i sistemoi;

- Hartoi planin e punës dhe aktiviteteve për fushat e AKRS;
- Nga themelimi e deri tash, punën dhe aktivitetet e suksesshme i zhvilloi me plan dhe program sistematik, sipas fushave që mbulon AKRS.
- Vuri themelet e AKRS, përcaktoi objektivat dhe qëllimet e punës;
- Hartoi metodologjia origjinale të punës, për monitorim të institucioneve shkollore;
- Përcaktoi indikatorët e funksionimit të shkollave në realizimin e misionit të tyre;
- Monitoroi gjendjen reale për fushat e AKRS, koleksionoi të dhëna, analizoi, interpretoi dhe ato i rekomandoi për departamentet Komunale;
- Në Asamble komunale, prezantoi dhe raportoi punën e AKRS;
- Për sektorin e arsimit, analizoi, argumentoi, dokumentoi indikatorët e monitorimit;
- Punë sistematike dhe transparente, ndërsa rezultatet e punës dhe aktivitetet janë të dokumentuara dhe dëshmuara para organeve komunale;
- AKRS, për tre vite, nga fillimi e deri tash me sukses, plotësoi boshllëkun ekzistues profesional dhe institucional të veprimtarisë së saj, e zhvilluar në baza vullnetare në interes të shoqërisë !

Arsyetim: Me vendim të themeluesit -Kuvendi Komunal i F. Kosovës, Nr.51/7.03.2022, në pikën 2. në mënyrë decitive janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e AKRS. Gjithashtu në pikën 5, e të njëjtit vendim, është përcaktuar mënyra e raportimit dhe kompensimit financiar për punën dhe aktivitetet e AKRS !

Tashmë kanë kaluar gati 3 (tre) vite të plota, por çështjes së tillë nuk iu është ofruar asnjë zgjidhje!

Kuvendi, me aktvendim legal mund të rregullojë mbështetjen financiare për realizimin e aktiviteteve specifike të Komitetit të AKRS, në pajtim me normat administrative dhe financiare.

Pas punës vullnetare tre vjeçare, moralisht na jep të drejtën për të konstatuar se “ Interesi për bashkëpunim, këmbim të përvojave dhe promovimi i vlerave dhe aktiviteteve të AKRS është më i madh, se sa kursimi i buxhetit apo mungesa e vullnetit të Kuvendit .

Realiteti ekzistues, rezulton me pasoja të izolimit lokal, ndërsa statusi i AKRS, do të jetë formalitet administrativ dhe pa substancë !

Prandaj, me pak vullnet të Asamblesë dhe Ekzekutivit Komunal, barriera e tillë mund të eliminohet, gjithnjë në interes të shoqërisë!